



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 27.10.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 26.10.2020, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “**MEDIATECH & PRINT**” sh.p.k., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “ **Furnizim me kompjuter dhe laptop**”-Loti II-të: **Furnizim me TV smart, me Nr. të Prok: 632-20-4552-1-2-1, Nr. Brendshëm 632-20-070-121, nxjerr:**

V E N D I M

- I. **1. Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik “**MEDIATECH & PRINT**” sh.p.k., e dt.26.10.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit “ **Furnizim me kompjuter dhe laptop**”-Loti II-të: **Furnizim me TV smart, me Nr. të Prok: 632-20-4552-1-2-1, Nr. Brendshëm 632-20-070-121., kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 19.10.2020, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
2. **Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES e publikuar me datë: 19.10.2020;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit .
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Arsyetim

Meqë Operatori Ekonomik “**MEDIATECH & PRINT**” sh.p.k., ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Furnizim me kompjuter dhe laptop**”-**Loti II-të: Furnizim me TV smart, me Nr. të Prok: 632-20-4552-1-2-1**, Nr. Brendshëm **632-20-070-121**, Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 27.10.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Ne Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar të dt.19.10.2020, kemi referuar arsyen se nuk jeni kualifikuar nga AK andaj po e përshkruajmë edhe një here arsyetimin:

Ne specifikat e AK është kërkuar përkrahja e TV me Google Assistant nga se kjo kërkesë është mese e nevojshme duke e ditur lidhshmërinë e pajisjeve me këtë shërbim andaj edhe është e domosdoshme dhe nuk mund te tejkalohet.

TV qe ju ofroni si OE i kemi analizuar me vëmendje te gjitha pikat si dhe kemi kërkuar ne faqen zyrtare te Hisense ku jemi informuar për detajet. Gjate hulumtimin te internet nuk kemi hasur qe TV qe ju e ofroni përkrah këtë opsion Google Assistant gjë qe qon automatikisht ne diskualifikim.

Sa i përket përzgjedhjes se OE fitues Modeli i ofruar nga OE fitues është TV Android i cili përfshin edhe Google Assistant dhe kemi verifikuar qe plotëson kërkesat e AK.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**



z.Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

Arkivit të Komunës